

# PËRGJIGJE PËR NJË INFORMACION I PUBLIKUAR NË LAJMET E TV TELMA

**Shkup, 22 korrik 2020** – Duke patur parasysh nevojën për të paraqitur të gjitha faktet, dhe jo vetëm qëndrimin e TV Telma me shkas ankesën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale kundër aktgjykimit për shkelje të heshtjes zgjedhore, të paraqitur në reagimin e sajë në lajmet e orës 18.30 , ne informojmë publikun me sa vijon :

Gjatë procesit zgjedhor, kompetenca themelore e Agjencisë është zbatimi i vazhdueshëm i Kodit Zgjedhor në fushën e përfaqësimit mediatik zgjedhor, që do të thotë se Agjencia monitoron rregullisht mbulimin e mediave dhe nëse konstaton shkelje, fillon procedime kundërvajtëse. Me këtë Agjencia nuk vendoset në rolin e redaktorit të mediave, përkundrazi, këto janë detyrime të rregullatorit.

Siç shpjegoi në ankesën e sajë të dërguar në Gjykatën e Apelit, është e drejtë që publiku të informohet në lidhje me situatën e koronavirusit dhe aktivitetet e autoriteteve shëndetësore, është e padiskutueshme, megjithatë, pa shkelur heshtjen e zgjedhore. Sipas Kodit Zgjedhor, gjatë heshtjes zgjedhore, deklaratat nuk duhet të transmetohen nga mbajtësit e funksioneve në organet qeveritare dhe informacioni, në vend të Ministrit i cili gjithashtu mori pjesë aktive në fushatën e Koalicionit “Mundemi” në takime me qytetarë dhe në reklama, mund të transmetohet në një mënyrë tjetër të përshtatshme, në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor, siç kanë bërë radiodifuzerët e tjerë.

Duke theksuar se Agjencia e kualifikon ngjarjen ku Ministri Venko Filipçe paraqitet si “fiktiv” dhe u sugjeron mediave që të transmetojnë ngjarjen pas zgjedhjeve, publiku është

mashtroar. Televizioni publikoi një pesë të informacionit me çka i shtrembëroi faktet. Përkatësisht, në procesverbalet pjesët të cilat i publikoi TV Telma është përcaktuar deklarata e drejtorit që gjatë heshtjes së zgjedhjeve, Telma mund të raportonte “për numrin e të infektuarve të rinj, të vdekur dhe të shëruar nga koronavirusi pa e dhënë me audio dhe video Ministrin Filipçe , ndërsa pas heshtjes zgjedhore mund të transmetojë një pjesë të informacionit mbi hapjen e qendrave rajonale KOVID të njoftuara, nga shtatori.

Në të njëjtën kohë, publiku mashtrohet duke cituar raportin e OSBE-së, posaçërisht pasi TV Telma i është mirë i njohur se ekuilibri në raportim gjatë fushatës dhe heshtjes zgjedhore nuk janë sinonim. Sidoqoftë, në mbrojtje të shkeljes së saj, Telma bëri barazimin, ndërsa duke lënë anësh që në të njëjtin Raport u vërejt shkelje e heshtjes zgjedhore edhe tek radiodifuzerët. Përndryshe, i njëjti institucion rregullisht vlerëson pozitivisht punën e rregullatorit, kështu që në raportin e fundit nuk u vërejtën vërejtje për Agjencinë.